



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 249, Datë 03.09.2026

MBI

**MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET
E GNL-SË ME PËRMASA TË VOGLA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 16, 22, pika 2, gërma “ë” dhe 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.09.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1527/1prot., datë 01.09.2026, të përparitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, si dhe miratimin e Licencave Tip për operimin e impianteve të GNL-së/GNK-së me përmasa të vogla”;

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 125, datë 06.05.2026, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit të impianteve të GNL-së me përmasa të vogla.
- Fillimi i procedurës për miratimin e Licencës Tip u vlerësua i nevojshëm në vijim të ndryshimeve të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, të miratuara me ligjin nr. 81/2021, nëpërmjet të cilave, ndër të tjera, në nenin 22, pika 2, është parashikuar si veprimtari që ushtrohet me licencë të lëshuar nga ERE edhe operimi në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla.
- Për efekt të vendimmarrjes së bordit, miratimi i Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla trajtohet veçmas nga miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren e licencimit dhe nga Licenca Tip për operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, duke qenë se secili prej këtyre akteve ka objekt dhe përmbajtje rregullatore të posaçme.

- Licenca Tip e hartuar përcakton kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, të drejtat dhe detyrimet e të licencuarit, kërkesat për kryerjen e aktivitetit të licencuar, raportimin, përdorimin e informacionit, pagesat e rregullimit, kontrollin mbi kryerjen e aktivitetit, ndryshimin dhe heqjen e licencës, si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.
- ERE në zbatim të procedurës së konsultimit publik, me shkresën nr. 1681 prot., datë 25.05.2026, njoftoi palët e interesit për fillimin e procedurave për miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit të impianteve të GNL-së me përmasa të vogla dhe konkretisht: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror “ALBGAS” sh.a.; Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); Ministrinë e Financave (MF); Autoritetin e Konkurrencës (AK); shoqërinë “Albpetrol” sh.a.; si dhe Operatorin e Pavarur të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror (TAP AG), duke u dhënë mundësinë për të paraqitur opinionet dhe komentet e tyre mbi ndryshimet e propozuara në rregullore.
- ERE publikoi njoftim edhe në dy gazeta me qarkullim kombëtar, përkatësisht në gazetat “Tema” dhe “Panorama”, në datat 08.07.2026 dhe 09.07.2026.
- Në përfundim të konsultimit, rezultoi se shoqëria “SOCAR Gas Albania”, me e-mailin e datës 12.06.2026, paraqiti komente dhe kërkesa për sqarim lidhur me projektaktet e publikuara për konsultim.
- Në lidhje me Licencën Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, shoqëria “SOCAR Gas Albania” kërkoi sqarim nëse furnizimi i drejtpërdrejtë i GNL-së te klientët nga mbajtësi i kësaj licence përfshihet në objektin e Licencës Tip apo kërkon pajisjen me një licencë të veçantë për furnizimin me gaz natyror.
- Në lidhje me sqarimin e kërkuar, ERE vlerësoi se Licenca Tip për operimin e impianteve të GNL-së me përmasa të vogla autorizon vetëm ushtrimin e aktivitetit të përcaktuar në objektin e saj dhe nuk shtrihet automatikisht mbi aktivitete të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror. Furnizimi me gaz natyror përbën një veprimtari të veçantë të rregulluar dhe të licencueshme nga ERE. Për rrjedhojë, kur aktiviteti i subjektit përfshin furnizimin me gaz natyror të klientëve, ushtrimi i këtij aktiviteti duhet të mbulohet nga licenca përkatëse e furnizimit, sipas kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të ERE-s.
- Po ashtu, në kuadër të komenteve dhe kërkesave për sqarim të paraqitura për Licencat Tip, shoqëria “SOCAR Gas Albania” kërkoi qartësimin e kuptimit të termit “shërbim transporti i ofruar klientëve”, me qëllim sqarimin e fushës së këtij shërbimi në raport me transportimin dhe dorëzimin e gazit natyror te klientët.
- ERE vlerësoi të nevojshëm qartësimin e këtij termi dhe, për këtë qëllim, në seksionin e përkufizimeve të Licencës Tip është përcaktuar se “shërbim transporti i ofruar klientëve” është shërbimi që lidhet me transportimin dhe dorëzimin e gazit natyror, përfshirë GNL/GNK, nga impianti me përmasa të vogla deri në pikën e dorëzimit te klienti, nëpërmjet mjeteve, pajisjeve dhe infrastrukturës së përshtatshme, në përputhje me kushtet kontraktore dhe legjislacionin në fuqi. Përfshirja e mjeteve, pajisjeve apo infrastrukturës në realizimin e këtij shërbimi nuk përcakton, në vetvete, mënyrën e licencimit apo autorizimit të tyre. Ndërtimi, zotërimi dhe

funksionimi i infrastrukturës përkatëse vlerësohen në përputhje me natyrën dhe funksionin e saj, si dhe me kërkesat dhe autorizimet e parashikuara nga legjislacioni dhe kuadri rregullator në fuqi.

- Në përputhje me këtë vlerësim, në seksionin e përkufizimeve të Licencës Tip është përfshirë përkufizimi i termit “shërbim transporti i ofruar klientëve”.
- Licenca Tip parashikon gjithashtu se i licencuari autorizohet të ushtrojë veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, ndërsa në rast se synon të ushtrojë veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, duhet të pajiset me licencat përkatëse, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.
- Nga shqyrtimi i komenteve dhe kërkesave për sqarim të paraqitura gjatë procedurës së konsultimit publik, për pjesën që lidhet me Licencën Tip objekt të kësaj vendimmarrjeje, u reflektuan në tekst sqarimet e vlerësuara të nevojshme.
- Miratimi i Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla plotëson kuadrin rregullator të licencimit për këtë veprimtari, të parashikuar nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe nga Rregullorja për procedurat dhe afatet e licencimit në sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Licencës Tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla. (dokumenti bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror “ALBGAS” sh.a., Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Ministrinë e Financave (MF), Autoritetin e Konkurrencës (AK), shoqërinë “Albpetrol” sh.a., Operatorin e Pavarur të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror (TAP AG), si dhe shoqërinë “SOCAR Gas Albania”, për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 249, Datë 03.09.2026

LICENCË

**PËR
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË ME PËRMASA TË
VOGLA**

Licenca i jepet: _____
NUIS: _____
Numri i Licencës: _____
Seria: _____
Data e Hyrjes në Fuqi: _____
Kohëzgjatja: _____

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në Ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) i jep këtë Licencë (“Licenca”), për të kryer veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, Personit të lartpërmendur, i quajtur “I Licencuari”, subjekt i Kushteve të Licencës të bashkangjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të përcaktuara nga bordi në vendimin e tij.

Kjo Licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë në rast se nuk hiqet nga ERE në përputhje me Kushtet e Licencës të përfshira këtu, apo parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

KRYETAR I ERE-s

KUSHTET E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-SË ME PËRMASA TË VOGLA

Neni 1

Dispozita të Përgjithshme

ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në Kreu III Seksionin I, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, për të lëshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj Licence.

1. Nëse ndonjë kusht i kësaj Licence bëhet nul ose i anulueshëm apo pushon së qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga Licenca dhe Kushtet e mbetura të Licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.
2. Në rastet e transferimit të Licencës, I Licencuari ka detyrimin të njoftojë menjëherë ERE-n.
3. ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë Licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar si dhe për të përmbushur dispozitat e Rregullave për Organizimin e Tregut të Gazit Natyror; Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, Kushtet e Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror; Kodin e Rrjetit të Transmetimit; Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes; Kodin Matjes; dhe/ose aktet nënligjore në fuqi të miratuara nga ERE në zbatim të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

Përkufizimet e termave të përcaktuara në:

- Ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar;
- “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 97 datë 04.07.2017;
- “Rregullore mbi procedurat e heqjes së licensave në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 58 datë 18.04.2017;
- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016;
- Rregullat dhe Rregulloret që i përkasin Sektorit të Gazit Natyror (Legjislacioni në fuqi), përfshihen në këtë Licencë për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë Licencë dhe në Kushtet e Licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

- **“Gaz Natyror i Lëngëzuar” (GNL)** është gazi metan CH₄, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.
- **“Impliant me përmasa të vogla”** është njësia lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së.
- **“Ndër-Subvencionime”**, do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të Licencuarit, ose llogaritë me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti apo biznesi përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror nga të ardhurat e fituara nga i Licencuari që kryen Aktivitetin e Licencuar, ose duke i kaluar kostot të shkaktuara nga i Licencuari gjatë kryerjes së Aktivitetit të Licencuar tek një aktivitet apo biznes tjetër përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror.

- **“Aktivitet i Licencuar”**, do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*, i ndryshuar, Rregullat për Organizimin e Tregut të Gazit Natyror, Kushtet e Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror, si dhe Rregullat dhe Rregulloret e tjera që aplikohen.
- **“I Licencuar”**, sikurse përdorur në këtë dokument, do të thotë Personi i përmendur në faqen e parë të kësaj Licence, që mban licencën e lëshuar nga ERE për kryerjen e Aktivitetit të Licencuar.
- **“Procedurat e Licencimit për Sektorin e Gazit Natyror”**, do të thotë procedura e parashikuar në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 97, datë 04.07.2017.
- **“Legjislacioni në fuqi”**, do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente sipas Ligjit nr. 102/2015 *“Për Sektorin e Gazit Natyror”*, i ndryshuar.
- **“Informacion me Ndjeshmëri Tregtare”**, do të thotë, të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të Përdoruesve të Sistemit, që zotërohen nga i Licencuari gjatë procesit të ushtrimit të Aktivitetit të Licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.
- **“Informacion me Avantazh Tregtar”**, do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të Licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’i bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuuese.
- **“Forcë madhore”**, është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
- **“Pagesa rregullatore”**, është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.
- **“Shërbim transporti i ofruar klientëve”**, është shërbimi që lidhet me transportin dhe dorëzimin e gazit natyror, përfshirë GNL/GNK, nga impianti i vogël deri në pikën e dorëzimit të klientit, nëpërmjet mjeteve, pajisjeve dhe infrastrukturës së përshtatshme, në përputhje me kushtet kontraktore dhe legjislacionin në fuqi

Neni 2

Kryerja e Aktivitetit të Licencuar

1. I Licencuari autorizohet nga kjo Licencë për të zhvilluar Aktivitetin e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla sipas Legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në rast se subjekti synon të ushtrojë edhe veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, si transmetimi, shpërndarja apo depozitimi, ai duhet të pajiset me licencat përkatëse për secilën prej tyre, në përputhje me nenin 22, gërma ë, të ligjit nr. 102/2015. Në çdo rast, i licencuari mban llogari të ndara për secilën veprimtari të licencuar, sipas nenit 30 të këtij ligji.
2. I Licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të ndalojë të Licencuarit e tjerë ose pjesëmarrësit potencialë ose konkurentët që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla apo në aktivitete të tjera në sektorin e Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë;

3. I Licencuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose anti-konkurrencë të ndaluar nga Legjislacioni dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. I Licencuari nuk mund të ushtrojë veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen apo depozitimin e gazit natyror, pa u pajisur me licencën përkatëse nga ERE.
5. Brenda datës 31 Janar të çdo viti, i Licencuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e gazit natyror, sipas kërkesave të raportimit të vendosura nga ERE sipas nenit 16, pika 24 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, I ndryshuar.
6. I Licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar interesat e të Licencuarve ose klientëve të Gazit Natyror.
7. I Licencuari do t'a kryejë Aktivitetin e Licencuar në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
8. I Licencuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga Aktiviteti për të cilin është Licencuar, duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon të:
 - a) angazhohet në aktivitet tjetër përveç aktivitetit të Licencuar; ose
 - b) të ngrejë një Biznes Shoqërues.
9. ERE mund t'a ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e Bizneseve Shoqëruese të nevojshëm për të mbrojtur interesat e klientëve.
10. I Licencuari nuk është përgjegjës për mos-përmbushjen e Kushteve të Licencës në rast të një Force Madhore deri në atë shkallë sa Forca Madhore është shkaku për këtë mos-përmbushje të Kushteve të Licencës. Në këtë rast, i Licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të Licencuarit e tjerë ose klientët me të cilët i Licencuari ka lidhur marrëveshje.

Neni 3 **Detyrimet e të Licencuarit**

1. I Licencuari është i detyruar të zbatojë Legjislacionin në fuqi dhe gjithë Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Rregulloret e Rregullat e miratuara nga ERE.
2. I Licencuari në aktivitetin e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, në zbatim të kësaj Licence, duhet:
 - a) të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë operatorit të tregut të gazit natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s.
 - b) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror.
 - c) të kryejë operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, duke garantuar funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të impianteve, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personelit, mbrojtjen e mjedisit, si dhe përmbushjen e standardeve teknike dhe të sigurisë në fuqi;
 - d) të sigurojë kushte objektive dhe jodiskriminuese, për akses të shërbimeve të ofruara në kuadër të aktivitetit të licencuar;
 - e) të kufizojë diskriminimin ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve të shërbimit të operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura;

- f) të mbrojnë informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- g) të sigurojnë funksionimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin periodik të impianteve, pajisjeve kriogjenike, sistemeve të sigurisë, sistemeve të matjes dhe pajisjeve nën presion, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- h) të hartojë dhe zbatojë procedura operative dhe plane emergjence për menaxhimin e rrjedhjeve, zjarreve, shpërthimeve, avarive teknike dhe çdo rreziku tjetër që lidhet me operimin e impianteve të GNL-së me përmasa të vogla;
- i) të sigurojë që personeli teknik i angazhuar në operimin e impianteve të jetë i trajnuar dhe i kualifikuar për operimin e sistemeve kriogjenike dhe infrastrukturës së gazit natyror.

Neni 4

Llogaritë dhe Raportimi

1. I Licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për Aktivitetin e Licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të Licencuara) ku është angazhuar i Licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 30 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar. Kur është e nevojshme dhe sipas kushteve të përcaktuara tek Rregullat dhe Rregulloret që aplikohen, këto llogari mund të ofrohen në një formë të konsoliduar. I Licencuari do t’i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 Mars të çdo viti. Nëse I Licencuari ushtron më shumë se një aktivitet, faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet që ushtron, duhet të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përket, me shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuar për të cilin janë përdorur. Në çdo rast të tillë, I Licencuari duhet t’i deklarojë ERE-s mënyrën e identifikimit të secilës faturë.
2. I Licencuari do të vërë në dispozicion të ERE-s, ministrisë, Autoritetit të Konkurrencës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse të dhënat përkatëse, për një periudhë, të paktën 5 vjetore, të gjitha transaksionet, në kontratat e sigurimit të aktivitetit të operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, me të licencuar të tjerë apo me klientët me shumicë, si kerkohet sipas nenit 77 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
3. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si:
 - a) kohëzgjatja,
 - b) rregullat e ofertës dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,
 - c) sasinë, datat,
 - d) kohën e ekzekutimit të kontratës,
 - e) çmimet e transaksionit,
 - f) mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë, detaje për të gjitha kontratat e papaguara
4. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i Licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.
5. I Licencuari njofton menjëherë ERE-n për çdo situatë emergjente që ndikon në funksionimin e impiantit, duke përshkruar masat e marra.
6. I Licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes Aktivitetit të tij të Licencuar dhe tipeve të tjera të aktiviteteve, në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s. I Licencuari do t’i paraqesë ERE-s, në kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur

7. I Licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:
 - a) adresës;
 - b) statutit të të Licencuarit;
 - c) çertifikatës së regjistrimit;
 - d) NUIS-it
 - e) organeve kryesore drejtuese; ose
 - f) strukturës së biznesit të Licencuar.
8. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me Licencën duhet të jenë me shkrim dhe e nënshkruar respektivisht nga një zyrtar i autorizuar ose përfaqësues ligjor i caktuar i të Licencuarit ose ERE-s, dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e Palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.
9. I Licencuari do të dërgojë në ERE informacion Periodik lidhur me:
 - a) Shpenzimet dhe të ardhurat operative (mujore, dhe në progresion 3-mujor);
 - b) Pasqyra Cash-Flow (mujore dhe progresive);
 - c) Tabela e të dhënave mbi sasinë e GNL-së me përmasa të vogla, të transportuara (mujore dhe progresive);
 - d) Çdo informacion të kërkuar rast pas rasti nga ERE;
 - e) Numrin e Klientëve për të cilët ka ofruar shërbimin e transportimit (mujore dhe progresive);
 - f) Grafikët e ngarkesës;
 - g) Sistemet e matjes;
 - h) Të dhëna mbi ankesat e rregjistruara, trajtimin dhe korrigjimet në faturimet përkatëse objekt ankimi (mujore dhe progresive);
 - i) Çdo informacion tjetër sipas Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kërkesave të raportimit të miratuara nga ERE sipas nenit 16 pika 24 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
10. I Licencuari I licencuari në aktivitetin e operimit në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla, për shërbimet e ofruara, është i detyruar të japë informacionin e përcaktuar me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme, në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme nga palët. I Licencuari duhet të publikojë:
 - a) informacionin e detajuar, në lidhje me shërbimet që ofron, kushtet përkatëse të aplikueshme dhe informacionin teknik të nevojshëm.
 - b) informacionin për kapacitetet e kontraktuara dhe të disponueshme, informacion që ofrohet në formë numerike, lehtësisht të aksesueshëm nga palët.
 - c) të dhënat mbi sasinë e gazit në çdo impiant, ose grup impiantesh, rrjedhave hyrëse e dalëse si dhe kapaciteteve në dispozicion në impiant, duke përfshirë edhe impiantet ku është përjashtuar akses i palës së tretë, në qoftë se ky detyrim korrespondon me mënyrën me të cilën është ofruar akses i përdoruesit e sistemit. Ky informacion i komunikohet OST-së kombëtare, licencuar nga ERE, e cila e bën publik, në mënyrë të përmblodhur, për sistemin apo nënsistemin. Informacioni përditësohet, të paktën, çdo ditë.
 - d) në mënyrë që të lehtësojë përdorimin efikas të infrastrukturës dhe të sigurojë tarifa transparente, objektive dhe jodiskriminuese, bën publik informacion të detajuar për metodologjinë dhe strukturën për përlllogaritjen e tarifave të infrastrukturës, nën aksesin e rregulluar të palëve të treta.

Neni 5

Përdorimi i Informacionit

1. I Licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i Aktivitetit të tij të Licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:
 - a) Jepet pëlqim paraprak me shkrim i Personit me të cilin lidhet informacioni;
 - b) Informacioni është bërë publik;
 - c) Kur të Licencuarit i kërkohet ose lejohet të përhapë informacionin për të përmbushur Kushtet e kësaj Licence sipas një urdhëri të ERE-s, ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;
 - d) Informacioni duhet përhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të Licencuar.
2. I Licencuari do të sigurojë që çdo Biznes Shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të Licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë Person tjetër (përfshirë Biznese të tjerë Shoqërues) që mund ta mundësojnë këtë Person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.
3. Çdo Informacion me Avantazh Tregtar në zotërim të të Licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese dhe duhet të aksesohet lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga konsumatorët aktualë dhe të mundshëm dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e Informacionit me Avantazh Tregtar duhet të përpunohet për të parandaluar trajtimet preferenciale të konsumatorëve individual, pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror ose palëve të tjera të interesuara, në lidhje me fushëveprimin, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë dhe/ose kohën kur ai është shpërndarë.
4. I Licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet Ligjore sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 "*Për Sektorin e Gazit Natyror*", i ndryshuar, Kushteve të Përgjithshme për Furnizimin me Gaz Natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.
5. Informacioni i dërguar ERE-s nga i Licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të Licencuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.
6. ERE ruan konfidencialitetin e Informacionit të Ndjeshëm Tregtar të marrë nga i Licencuari sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara tek Rregulloret dhe Rregullat që aplikohen sipas neneve 16 pika 15 dhe 20 të Ligjit nr. 102/2015 "*Për Sektorin e Gazit Natyror*", i ndryshuar.
7. I Licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje të cilat i Licencuari e di ose duhet t'a dijë që çojnë në shkelje të Kushteve të Licencës.
8. I Licencuari do të respektojë Ligjet dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloret e Rregullat e ERE-s.

Neni 6

Pagesat e Rregullimit

1. I Licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj Licence siç përcaktohet nga ERE në Rregulloren për pagesat e rregullimit si dhe nenin 14 të ligjit nr. 102/2015 "*Për sektorin e Gazit Natyror*", i ndryshuar.

2. Nëse i Licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i Licencuari do të penalizohet në përputhje me ligjin nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe Rregulloren mbi Kushtet dhe Procedurat e Vendosijes së Gjjobave dhe Masën Konkrete për çdo Shkelje, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 04.07.2017.

Neni 7

Kontrolli mbi Kryerjen e Aktivitetit të Licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i Licencuari të Kushteve të Licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i Licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të Licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të Licencuarit. Për këtë qëllim, ERE ndër të tjera duhet të ketë akses të pakufizuar tek llogaritë e të Licencuarit sipas neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.
2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të Licencuarit për të inspektuar Veprimtarinë e Licencuar sipas Rregullave të ERE-s. I Licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.
3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i Licencuari të Kushteve të Licencës ose Rregullave të ERE-s.
4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i Licencuari nuk i ka respektuar Kushtet e Licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj Licence.
5. I Licencuari do t’a informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të Kushteve të Licencës, jo me vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të Licencuarit.
6. I Licencuari do t’u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjjobave të vëna nga ERE, sipas Legjislacionit në Fuqi.

Neni 8

Amendimi i Licencës

1. ERE mund të ndryshojë/shfuqizojë Kushtet e Licencës në rast se ato nuk përputhen me:
 - a) Legjislacionin në fuqi dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
 - b) Vendimet e nxjerra nga një Gjykatë Shqiptare me kompetencë juridiksionale.
2. Në çdo kohë I Licencuari mund t’i propozojë ERE-s ndryshime të tjera të Kushteve të kësaj Licence, duke paraqitur një propozim me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse. ERE mund të propozojë ndryshime të kushteve të kësaj Licence e ti konsultojë ato me palët e interesit përpara miratimit.
3. ERE do të marrë vendimin përfundimtar vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e klientëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo ndryshim të propozuar. Nëse ERE dhe I Licencuari arrijnë një marrëveshje për këto ndryshime, Kushtet e Licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, I Licencuari mund të apelojë në Gjykatën Administrative Tiranë.
4. Të gjitha ndryshimet tek Kushtet e Licencës duhet të kryhen nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Procedurës së Licencimit për Sektorin e Gazit Natyror dhe Rregulloreve dhe Rregullave të tjera që aplikohen.

5. Amendamentet e bëra në Kushtet e Licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Vendosja e masave administrative dhe Heqja e Licencës

1. Nëse i Licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj Licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, dhe Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje.
2. ERE mund të heqë Licencën në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe Rregullores për procedurat e heqjes së Licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Neni 10

Heqja e Licencës

1. ERE heq një licencë kur I Licencuari:
 - a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të Licencës;
 - b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
 - c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
 - d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
 - e) bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit;
 - f) me kërkesë të të licencuarit;
 - g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas Licencës.
2. Licenca mund të hiqet nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara tek ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Procedurave të Licencimit për Sektorin e Gazit Natyror, Rregullores mbi procedurat e refuzimit të licencës në Sektorët e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, si dhe Rregullave dhe Rregulloreve të tjera që aplikohen.

Neni 11

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe e Drejta për Apelim

1. Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të Licencuarit dhe çdo Pjesëmarrësi Tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.
2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të kërkesës së çdo Personi që është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me nenin 98 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Konsumatorët dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve në Sektorët e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114 datë 08.07.2016
3. I Licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.